Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Kuçi	**20.08.2026**	**28.08.2026**	**2026/0596**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.08.2026, OE "Petrol Company - SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0596, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "IP-KOS-SH.P.K."- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me karburante" me nr. të prokurimit: "201/26300-26-2068-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokruimit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontrates: furnizim, vlera e parashikuar e kontrat:

Lot 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror- 2,710,000.00 €

Lot 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal) -2,170,000.00€

Lot 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal) - 1,305,000.00€

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

PRETENDIMI NR. 1

MOSPËRMBUSHJA E KËRKESËS NR. 4 – GARANCIONI/AUTORIZIMI NGA RAFINERIA/PRODHUESI

Në Kërkesën për Rishqyrtim, kompania jonë ka ngritur pretendimin ankimor lidhur me

mospërmbushjen e Kërkesës nr. 4 të Dosjes së Tenderit, e cila kërkonte:

Kërkesa nr. 4: "Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."

Si evidencë për përmbushjen e kësaj kërkese është kërkuar: ***"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria – që garanton që do të furnizojë për kontratën/Lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."***

Gjatë procedurës së prokurimit, një operator ekonomik ka kërkuar sqarim nëse do të pranohej edhe autorizimi ose konfirmimi i lëshuar nga distributori zyrtar i prodhuesit/rafinerisë. Pyetja ka qenë: *"Ju lutem të sqaroni dhe konfirmoni nëse do të pranohet edhe autorizimi apo konfirmimi i lëshuar nga distributori zyrtar i prodhuesit/rafinerisë, i cili vepron si përfaqësues i autorizuar dhe realizon furnizimin e mallrave të kërkuara."* Autoriteti Kontraktues, në përgjigjen e publikuar më datë **20.05.2026**, ka deklaruar: ***"Nuk aprovohet. Kërkohet një garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria ku furnizoheni. Nuk pranohet nga çfarëdo distributori që nuk është rafineri."*** Ky sqarim është pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të ofertave.

Pas publikimit të Njoftimit mbi Vendimin (Formulari B58), kompania jonë ka realizuar qasje në ofertën e operatorit ekonomik të shpallur fitues, **IP-KOS Sh.p.k.**, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit është konstatuar se dokumenti i dorëzuar për përmbushjen e Kërkesës nr. 4 nuk është në përputhje me kërkesën e Dosjes së Tenderit dhe as me sqarimin zyrtar të Autoritetit Kontraktues. Dokumenti mban titullin **"Confirmation and Supply Guarantee for Tender No. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lots 1, 2, 5, 7 and 8)"**, me datë **29.05.2026**, drejtuar Agjencisë Qendrore të Prokurimit, dhe ka për lëndë "Konfirmim dhe Garanci për Furnizim për Tenderin Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8)".

Data: *29 maj 2026*
Për: *Agjencia Qendrore e Prokurimit*
Lënda: *Konfirmim dhe Garanci për Furnizim për Tenderin Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1 (Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8)*

*Bazuar në bashkëpunimin tonë ekzistues tregtar, konfirmojmë dhe garantojmë aftësinë dhe angazhimin tonë për të siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë me produkte të naftës për **IP-KOS Sh.p.k.**, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve të saj sipas Tenderit Nr. 201/26300-26-2068-1-1-1, konkretisht për Lotet 1, 2, 5, 7 dhe 8, në rast*

*se **IP-KOS Sh.p.k.** shpallet fituese e kontratës(ave) përkatëse. Ky konfirmim lëshohet me kërkesë të **IP-KOS Sh.p.k.**, vetëm për qëllime të pjesëmarrjes në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik.*

Me respekt,** Për dhe në emër të **BP Oil International Limited / GEGA OIL GROUP SH.A.

Në këtë dokument thuhet se **"BP Oil International Limited, nëpërmjet furnizuesit të saj të autorizuar GEGA OIL SH.A., mban një marrëdhënie aktive tregtare furnizimi me IP-KOS Sh.p.k."**, ndërsa më tej konfirmohet dhe garantohet furnizimi me produkte të naftës për IP-KOS Sh.p.k. për qëllimet e përmbushjes së detyrimeve sipas tenderit. Dokumenti përfundon me formulimin: **"For and on behalf of BP Oil International Limited / GEGA OIL GROUP SH.A."**

Nga vetë përmbajtja e dokumentit rezulton se marrëdhënia komerciale dhe furnizimi realizohen **përmes GEGA OIL SH.A., e cila identifikohet si "authorized supplier"**. Pra, dokumenti nuk e paraqet marrëdhënien ndërmjet IP-KOS Sh.p.k. dhe BP Oil International Limited si një furnizim të drejtpërdrejtë, por e lidh atë përmes një furnizuesi të autorizuar. Kjo është pikërisht rrethana për të cilën Autoriteti Kontraktues, në sqarimin e datës 20.05.2026, kishte deklaruar shprehimisht se **"Nuk pranohet nga çfarëdo distributori që nuk është rafineri."** Për rrjedhojë, pranimi i një dokumenti të tillë gjatë vlerësimit ngre çështjen nëse Autoriteti Kontraktues ka aplikuar të njëjtin standard që kishte përcaktuar në sqarimin zyrtar të tenderit.

Për më tepër, dokumenti nuk përmban elemente të mjaftueshme për të identifikuar qartë personin nënshkrues, pozitën e tij zyrtare dhe kompetencën për të vepruar në emër të **BP Oil International Limited**. Në veçanti, nuk identifikohet qartë emri dhe pozita zyrtare e personit nënshkrues, autorizimi i tij për të vepruar në emër të BP Oil International Limited, apo dokumenti që dëshmon kompetencën e tij për të lëshuar një garancion ose konfirmim të tillë.

Në Kërkesën për Rishqyrtim, kompania ionë ka ngritur edhe dyshime lidhur me personin

Qëndrimi i AQP-së në vendimin për Kërkesën për Rishqyrtim

Me datë **03.08.2026**, AQP ka refuzuar këtë pretendim, duke arsyetuar, ndër të tjera, se **"BP" është prodhues** dhe se dokumenti përmban konfirmimin e "BP"-së që mbështet drejtpërdrejt IP-KOS Sh.p.k.

Citat: *Refuzohet pretendimi qe Konfirmimi nga prodhuesi nuk eshte sipas kerkeses se AK-se si dhe refuzohet pretendimi qe ky konfirmim nuk eshte ne harmoni me sqarirnin e ofruar nga AK kjo pasi qe "BP" eshte prodhues dhe ne* ***dokumentin e dorezuar nga IP-KOS shpk, eshte konfirmimi nga "BP" qe perkrah direkt IP-KOS shpk****, kete edhe po e citojme "Based on our existing commercial cooperation, we hereby confirm and guarantee our ability and commitment to ensure the continuous and uninterrupted supply of petroleum products to IP-KOS Sh.p.k for the pupose of fullfillingits obligations under Tender No.201/26300-26-2068-J-I-I, specifically for Lots 1,2,5,7 and 8, should IP-KOS Sh.p.k be awarded the respective contract(s)." Pra me kete rast nuk ka asnje dyshim qe ky konfirmim ploteson kerkesen e dosjes se tenderit dhe sqarimeve pasi qe "BP" nuk eshte distributor por eshte prodhues prej me te medhenjve ne bote. Pra ne sqarime nuk eshte lejuar qe konfirmimi te jete nga distributori por qe ne kete rast konfirmimi eshte nga "BP". Sa i perket pretendimit qe personi qe ka nenshkruar nuk eshte kompetent nga "BP" AK-AQP per hire te transparences* ***ka derguar kete dokument edhe ne email adresen e " BP", ju njoftojme qe deri ne keto momente nuk e ka kontestuar dhe nuk ka derguar ndonje informacion per te****, ndersa nga ofertuesi kemi kerkuar sqarim te cilet kane bashkangjitur nje deklarate te nenshkruar dhe vulosur me c'rast edhe mbajne pergjegjesin per vertetesine e ketij dokumenti, gjithsesi edhe ankuesi (si dhe dy Operator tjere Ekonomik) ka pasur ate dokument dhe para dergimit te kerkeses per rishqyrtim ka pasur mundesin ta konfirmoj nese eshte i falsifikuar dokumenti dhe edhe me tutje nese ka fakte te tilla besojme qe duhet te ju drejtohet organeve tjera kompetente pasi qe ne nuk mund ta verifikojme. Bazuar ne keto informacion konsiderojme qe vleresimi eshte kryer ne harmoni te plote me LPP-ne dhe pretendimet tuaja refuzohen te pabazuar.*

Megjithatë, pas këtij vendimi, kompania jonë, për shkak të rëndësisë së çështjes dhe për të eliminuar çdo paqartësi lidhur me autenticitetin e dokumentit, iu drejtua drejtpërdrejt **BP Oil International Limited** më datë **04.08.2026**, duke kërkuar konfirmim lidhur me dokumentin në fjalë. Me datë **06.08.2026**, BP iu përgjigj kërkesës sonë me deklaratën: **"We can confirm that we do not recognise the letter referred to in your correspondence, and we are taking appropriate steps in response."**

Në gjuhën shqipe, BP ka deklaruar: **"Mund të konfirmojmë se nuk e njohim letrën e referuar në korrespondencën tuaj dhe se po ndërmarrim hapat e duhur në përgjigje të kësaj çështjeje."** Kjo përgjigje është jashtëzakonisht relevante për çështjen objekt shqyrtimi, pasi nuk kemi të bëjmë më vetëm me një dyshim të ngritur nga kompania jonë lidhur me autenticitetin ose kompetencën e nënshkruesit, por me një **konfirmim të drejtpërdrejtë nga vetë subjekti në emër të të cilit pretendohet se është lëshuar**

Një rrethanë tjetër me rëndësi të veçantë është mënyra se si vetë AQP e ka trajtuar çështjen e verifikimit të dokumentit. Nga vendimi i AQP-së rezulton se AQP, për shkak të çështjeve të ngritura lidhur me autenticitetin dhe kompetencën e nënshkruesit, i është drejtuar drejtpërdrejt BP-së për të kërkuar sqarim/verifikim të dokumentit. Në atë fazë, BP nuk kishte dhënë përgjigje. Pikërisht për këtë arsye, AQP më pas i është drejtuar **IP-KOS Sh.p.k.** dhe i ka kërkuar që të sigurojë sqarimin/konfirmimin nga BP. Kjo tregon se vetë AQP e ka konsideruar verifikimin nga BP si relevant dhe të nevojshëm për të vlerësuar autenticitetin dhe vlefshmërinë e dokumentit.

Nëse dokumenti ishte realisht i lëshuar nga BP dhe nëse IP-KOS Sh.p.k. kishte pasur komunikim real me BP lidhur me lëshimin e tij, operatori ekonomik kishte mundësi konkrete që të siguronte konfirmimin nga burimi origjinal. Megjithatë, në vend që të sigurohej një konfirmim nga BP se dokumenti ishte lëshuar dhe njihej prej saj, AQP ka pranuar një deklaratë nga IP-KOS Sh.p.k. dhe e ka konsideruar atë të mjaftueshme për të mbështetur vërtetësinë e dokumentit.

Në këtë pikë duhet të bëhet një dallim thelbësor ndërmjet mungesës së përgjigjes së BP-së dhe përgjigjes së saj të mëvonshme. Në vendimin e datës **03.08.2026**, AQP është mbështetur, ndër të tjera, në faktin se dokumenti i ishte dërguar BP-së për verifikim dhe se BP nuk e kishte kundërshtuar atë deri në atë moment. Megjithatë, pas datës **06.08.2026**, kjo gjendje faktike ka ndryshuar në mënyrë thelbësore. Tashmë nuk kemi më vetëm mungesë të përgjigjes, por kemi një përgjigje të qartë dhe eksplicite të BP-së: **"We can confirm that we do not recognise the letter referred to in your correspondence."** Për rrjedhojë, AQP nuk mund të mbështetet më në mungesën e mëparshme të përgjigjes së BP-së si argument në favor të dokumentit, pa trajtuar faktin e ri dhe material se BP tani ka deklaruar shprehimisht se **nuk e njeh letrën**.

Në të njëjtën mënyrë, deklarata e IP-KOS Sh.p.k. se dokumenti është i rregullt nuk e zëvendëson verifikimin nga BP. Çështja nuk është vetëm nëse IP-KOS Sh.p.k. deklaron se dokumenti është i vërtetë, por nëse dokumenti është lëshuar realisht nga **BP Oil International Limited**, nëse njihet nga BP Oil International Limited, nëse është nënshkruar nga një person i autorizuar për të vepruar në emër të BP-së dhe nëse përmbush kërkesën e detyrueshme të Dosjes së Tenderit. Këto çështje lidhen drejtpërdrejt me vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur për përmbushjen e Kërkesës nr. 4.

Për më tepër, nëse IP-KOS Sh.p.k. ka pasur komunikim real me BP lidhur me këtë dokument, atëherë operatori ekonomik do të duhej të ishte në gjendje të siguronte dokumentacion ose komunikim të verifikueshëm që sqaron mospërputhjen ndërmjet dokumentit të paraqitur në ofertë dhe deklaratës së mëvonshme të BP-së. Një deklaratë e vetë IP-KOS Sh.p.k. nuk mund të zëvendësojë konfirmimin e burimit origjinal, veçanërisht pasi ky burim tashmë ka deklaruar se **nuk e njeh dokumentin**.

Në këtë kontekst duhet të merret parasysh edhe dispozita e **nenit 38.7 të LPP-së**, sipas së cilës: **"Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK sipas paragrafit 38.6 tenderi përkatës do të refuzohet."** Rëndësia e kësaj dispozite në rastin konkret qëndron në faktin se AQP i ka kërkuar IP-KOS Sh.p.k. që të sigurojë sqarimin/verifikimin e nevojshëm nga BP, pikërisht për të adresuar dyshimet lidhur me dokumentin e paraqitur. Pra, vetë AQP ka konsideruar se verifikimi nga BP ishte i nevojshëm për të përcaktuar vlefshmërinë e dokumentit. Në këto rrethana, në vend të një deklarate të vetë IP-KOS Sh.p.k., duhej të sigurohej sqarimi nga burimi origjinal, përkatësisht nga BP.

Neni 59 i LPP-së përcakton se Autoriteti Kontraktues duhet ta konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit. Në rastin konkret, Kërkesa nr. 4 ka qenë kërkesë e detyrueshme. Nëse dokumenti i paraqitur për përmbushjen e kësaj kërkese pretendohet se është lëshuar nga BP, por vetë BP më pas deklaron se **nuk e njeh atë**, atëherë ekziston një çështje materiale lidhur me vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur. Autoriteti Kontraktues nuk mund ta konsiderojë ofertën si të përgjegjshme vetëm mbi bazën e deklaratës së operatorit ekonomik, pa trajtuar në mënyrë të arsyetuar përgjigjen e drejtpërdrejtë të subjektit që pretendohet se e ka lëshuar dokumentin.

Ekziston një mospërputhje e qartë ndërmjet arsyetimit të AQP-së të datës **03.08.2026** dhe faktit të ri të paraqitur më **07.08.2026**. Në vendimin e datës 03.08.2026, AQP është mbështetur, ndër të tjera, në faktin se dokumenti i ishte dërguar BP-së për verifikim, se BP nuk e kishte kundërshtuar dokumentin dhe se IP-KOS Sh.p.k. kishte deklaruar se dokumenti ishte i vërtetë. Pas datës 06.08.2026, gjendja faktike është ndryshuar: BP ka dhënë përgjigje, nuk e ka konfirmuar dokumentin dhe, përkundrazi, ka deklaruar se **nuk e njeh dokumentin**. Kjo përgjigje i është përcjellë AQP-së më **07.08.2026**. Për rrjedhojë, një nga bazat faktike mbi të cilën AQP ka mbështetur arsyetimin e saj nuk mund të trajtohet më si e tillë

Përfundim

Bazuar në të gjitha rrethanat e lartcekura, konsiderojmë se çështja nuk mund të trajtohet më vetëm mbi bazën e dokumentit të paraqitur nga IP-KOS Sh.p.k. dhe deklaratës së saj për vërtetësinë e këtij dokumenti.

Kjo për shkak se:

Dosja e Tenderit kërkonte shprehimisht garancion, autorizim ose konfirmim nga rafineria/prodhuesi;

Autoriteti Kontraktues kishte sqaruar shprehimisht se nuk pranohej konfirmimi nga distributorët që nuk janë rafineri;

IP-KOS Sh.p.k. ka paraqitur një dokument që pretendohet se është lëshuar në emër të BP Oil International Limited;

AQP, për shkak të dyshimeve lidhur me dokumentin, vetë i është drejtuar BP-së për verifikim;

BP fillimisht nuk kishte dhënë përgjigje, për çka AQP i kishte kërkuar IP-KOS Sh.p.k. që të siguronte përgjigjen nga BP;

më 06.08.2026, BP është përgjigjur në emailin e kompanisë sonë dhe ka deklaruar se nuk e njeh letrën në fjalë;

këtë përgjigje ia kemi përcjellë AQP-së më 07.08.2026; me 12.08.2026 kemi pranu email qe i eshte derguar shkresa direkt AQP-se dhe,

pavarësisht këtij fakti të ri, AQP nuk ka ndërmarrë veprime të mëtejme për ta trajtuar në mënyrë substanciale këtë përgjigje.

Në këto rrethana, konsiderojmë se AQP ka pasur detyrimin që, pas pranimit të përgjigjes së BP-së të datës **06.08.2026**, ta rishqyrtojë përfundimin lidhur me përmbushjen e Kërkesës nr. 4 dhe të japë një arsyetim konkret se si mund të konsiderohet i vlefshëm një dokument të cilin vetë subjekti në emër të të cilit pretendohet se është lëshuar deklaron se **nuk e njeh**. Pranimi i kësaj përgjigjeje dhe mosadresimi i saj nuk mund të konsiderohet çështje formale, pasi ajo prek drejtpërdrejt **autenticitetin, burimin dhe vlefshmërinë e dëshmisë së paraqitur për përmbushjen e një kërkese të detyrueshme të Dosjes së Tenderit**.

Në përfundim, konsiderojmë se pranimi i ofertës së IP-KOS Sh.p.k. si ofertë e përgjegjshme, pa trajtuar dhe pa dhënë arsyetim të bazuar mbi përgjigjen e drejtpërdrejtë të BP-së, përbën cenim të kërkesave të Dosjes së Tenderit dhe të dispozitave të LPP-së që rregullojnë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Shkelja e dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik

Veprimi i Autoritetit Kontraktues për pranimin dhe vlerësimin si të përgjegjshme të ofertës së operatorit ekonomik **IP-KOS Sh.p.k.**, përkundër faktit se ky operator ekonomik nuk ka dëshmuar përmbushjen e Kërkesës nr. 4 të përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përbën shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik. Konkretisht, Autoriteti Kontraktues ka shkelur

nenin 1 të LPP-së – Qëllimi i Ligjit, pasi nuk ka siguruar zhvillimin e një procedure të drejtë, transparente dhe konkurruese;

nenin 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, pasi nuk ka garantuar përzgjedhjen e një operatori ekonomik që plotëson të gjitha kërkesat e përcaktuara;

nenin 7 të LPP-së – Barazia në Trajtim dhe Mos-Diskriminimi, pasi ka aplikuar standarde të ndryshme në interpretimin dhe zbatimin e kërkesave të Dosjes së Tenderit, duke krijuar avantazh të padrejtë për operatorin ekonomik të shpërblyer me kontratë;

nenin 53 të LPP-së – Sqarimet, pasi Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar interpretimin zyrtar të dhënë përmes sqarimit të publikuar, ku kishte përcaktuar qartë se dokumentet e lëshuara nga distributorët që nuk janë rafineri nuk do të pranoheshin;

nenin 56 të LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, pasi kontrata është dhënë për një operator ekonomik që nuk ka dëshmuar përmbushjen e kërkesave të detyrueshme të përcaktuara në Dosjen e Tenderit;

nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, pasi Autoriteti Kontraktues ka pranuar një ofertë që nuk është në përputhje me kërkesat teknike dhe profesionale të tenderit;

nenin 60 të LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës, pasi kontrata është dhënë duke mos u bazuar në një ofertë të përgjegjshme dhe të pajtueshme me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit; di dhe

nenin 38.6 te Rregullores se prokurimit publik , pasi qe nuk ka pranuar pergjigjen ne kerkesen per sqarim

Për këtë arsye, kërkojmë që gjatë shqyrtimit të mëtejmë të konstatohet se oferta e **IP-KOS Sh.p.k.** nuk ka dëshmuar në mënyrë të vlefshme përmbushjen e Kërkesës nr. 4, ose së

KRITERET PËR VLERËSIM

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	**Kërkesat e Pranueshmërise:** **Kërkesa 1:** Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e speci nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligjit nr. 04/L-042 për Pro Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin N 237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin. No. 05/L-092. LPP mund të shkarko http://krpp.rks-gov.net. **Dëshmia e kërkuar dokumentare:** **Evidenca 1: Një deklarata e shkruar nën Betim**, e nënshkruar nga t duke përdorur formën në Aneksin 2. **Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise qe kërkohen nga te propozohet qe te shpërblehet me kontrate dhe dorëzohen te Autor Kontraktues para publikimit te Njoftimit për Dhënie te Kontratës:** **Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te te pranueshmërise janë me se vijon:** **Vërtetim te lëshuar nga gjykata** apo autoritetet administrative të v themelimit të tenderuesit për situatën referuar nenit 65, paragrafi 3, n paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi dhe 4.4, (jo me e vjetër se 6 muaj para datës se dorëzimit të tenderit – **Valide** **Një vërtetim te lëshuar nga Administrata Tatimore** e vendit të the operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me von pagimin e tatimeve dhe kontributeve së paku deri në tremujorin e func para datës se dorëzimit të tenderit).-**Valide** Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe te shpërblehet kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 1 dhe 2 i jep te dr Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, ta beje konfiskimin e gara sigurim te ofertës dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Oper Ekonomik qe është rendit ne vendin e dyte e kështu me radhe. Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në ras lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë t

		rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga t mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme. Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, të anëtarët e këtij grupi duhet të dorezojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë sipas nenit Pjesën 6.4 të FDT-së, kjo vlen edhe per nenkontraktoret. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që tenderuesi do të refuzohet , do ti konfiskohet garancioni i sigurimit dhe AQP do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1	**Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:** **Kërkesa 1.** Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të theme **Kërkesa 2.** Operatori ekonomik duhet të jetë i licencuar nga Ministria dhe Industrisë(MTI) se Republikës së Kosovës për import, shitje me s shitje me pakicë si dhe licencë për transport të derivateve të Karburan dhe benzin.
	7.2	**Dokumentet dëshmuese për përshtatshmëri profesionale** **Evidenca 1:** Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i o ekonomik në atë vend (Çertifikata e regjistrimit te biznesit) . **Evidenca 2:** Licencat për shërbime në sektorin e karburanteve: Licenca e importit – **Valide** Licenca e shitjes me shumicë – **Valide**

		Licenca e transportit – **Valide** Licencën e shitjes më pakicë për pikat e karburantit të paraqitura nga Ekonomik (aneksi 9) për ofrimin e furnizime me karburante – Valide Për pikat e karburantit qe priten te nënkontraktohen duhet të dorëzohe e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nënkontraktim. Te gjitha licencat e lëshuara nga institucionet perkatse duhet që të ke validitetit në kohen e dorëzimit te ofertës. Dështimi i Operatorit Ekonomik që është propozuar që të shpërblehet të dorëzoj Licencat e shitjes më pakicë dhe marrëveshjet për nën-kon pikat e karburantit të nën-kontraktuara, i jep te drejte Autoritetit Kontra ofertën ta refuzoj, të bëjë konfiskimin e garancionit për sigurim të ofert vazhdoj me shpërblim të kontratës Operatorin Ekonomik që është ren vendin e dyte e kështu me radhe.
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1	**Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare** **Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ketë realizuar qarkullim mini per tri vitet e shkuara, **xhiro totale në EURO** minimum: **Lot 1 – 10,380,000.00€** **Lot 2 – 5,420,000.00€** **Lot 3 – 3,520,000.00€** **Lot 4 – 7,400,000.00€** **Lot 5 – 4,340,000.00€** **Lot 6 – 1,350,000.00€** **Lot 7 – 2,610,000.00€** **Lot 8 – 3,020,000.00€** **Lot 9 – 1,420,000.00€** **Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për te gjitha pjesët shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për tu shpërblye kontratë për të gjitha Pjesët-Lotet është totali i gjithave apo 39,46**

		Apo në rast se OE oferton vetëm për disa Pjesë-Lote per tu shpër kontratë duhet të plotësoj kërkesën duke pasur qarkullimin finan vlerën e atyre Pjesëve-Loteve së bashku (vlerat e paraqitura më l të mblidhen për Pjesët që ofertoni). **Kërkesa 2:**Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka kapital financi realizimin e kontratës, mjete të gatshme në bankë ose mbështetje ban te pakushtezuar në kredi për realizimin e kontratës ose bilanc pozitive dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit ne Pasqyra e rrjedhjes së pa vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025- në vlerë prej së paku: **Lot 1 – 775,000.00€** **Lot 2 – 405,000.00€** **Lot 3 – 264,000.00€** **Lot 4 – 550,000.00€** **Lot 5 – 325,000.00€** **Lot 6 – 100,000.00€** **Lot 7 - 195,000.00€** **Lot 8 – 225,000.00€** **Lot 9 – 105,000.00€**
	8.2	**Dokumentet dëshmuese për gjendjen ekonomike dhe financiare** **Evidenca 1:** Deklaratat Tatimore të dorëzuara në Administratën Tatir Kosovës për 3 vitet e shkuara. Operatori ekonomik qe përmbush kërkesën e qarkullimit vetëm me vite. Do të thotë se OE ka përmbushur kërkesën minimale te pë dokumentet e tenderit, kusht i domosdoshëm dhe i detyruesh kualifikuar. **Evidenca 2:** Deklaratë nga banka që dëshmon se OE ka mjete të xhirollogari ose qasje te pakushtezuar në kredi për realizimin e kc Pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2(prej minimumit te paraqitur tek kërkesa per secilin Lot qe oferton. Nese dorëzohet dëshmi nga banka per mjete te gatshme dokum origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni Bankar. Në rastin e pakushtezuar OE duhet të paraqes dokumentin nga banka në emër

		te prokurimit – origjinal. Në rast se dorëzohen pasqyra e rrjedhës se vitin qe përfundon me 31.12.2025 duhet te jene te nënshkruara nga rishikim i pasqyrave financiare.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1	**Kërkesa 1:** Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfundu sukses furnizim me karburante në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga publikimit te këtij njoftimi për kontrate) jo me pak se: **Lot 1 – 7,785,000.00€** **Lot 2 – 4,065,000.00€** **Lot 3 – 2,640,000.00€** **Lot 4 – 5,550,000.00€** **Lot 5 – 3,225,000.00€** **Lot 6 – 1,010,000.00€** **Lot 7 - 1,955,000.00€** **Lot 8 – 2,265,000.00€** **Lot 9 – 1,065,000.00€** **Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për te gjitha pjesët shuma totale e dëshmive qe kërkohet për tu shpërblyer me kontra gjitha Pjesët-Lotet është totali i gjithave apo 29,590,00€ .** **Apo në rast se OE oferton vetëm për disa Pjesë-Lote per tu shpër kontratë duhet të plotësoj kërkesën duke pasur dëshmit në vlerë Pjesëve-Loteve së bashku (vlerat e paraqitura më lartë duhet të m për Pjesët që ofertoni).** **Kërkesa 2:**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka në mjetet transportuese të regjistruara dhe të bazhdaruara/verifiku rrjedhjen dhe vëllimin e autoboteve, për realizim të kontratës –p dhe Lot 3 nga 4 autobot. Per Lot 4 – 5 autobot. Për Lot 5,6,7,8 k kërkohet nga 2 autobot për secilin Lot. Per tu shpërblyer me kor disa Lote duhet te plotësoj kriteret për të gjitha mjetet e kërkua Lote. (p.sh per tu shpërblyer me Lot 1, Lot 5 dhe Lot 9 duhet të autobote). **Kërkesa 3:**Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj një listë të pika shitjes se karburanteve qe planifikon për ti shfrytëzuar për realiz kontratës. Vendet e pikave te shitjes te cilat kërkohen janë të s në Aneksin 9;

		Pavarsisht pikave të cekura nga ana e oferturesit gjatë realizimit kontratës kontraktuesi ka obligim që ti ofrojë shfrytëzuesve të k gjitha pikat e veta në territorin e Kosovës, për rastet kur oferton OE këtë obligim e ka lideri i Grupit. – **Kjo kërkese nuk vlenë për L Lot 4 (vlen per të gjitha Lotet tjera).** **Kërkesa 4:** Garancion apo autorizim apo konfirmim nga raftineria/prodhuesi **Kërkesa 5:** Deklarat e kualitetit mbi plotësimin e specifikave tekn AD-Blue – **Kjo kërkese nuk vlenë për Lot 3 dhe Lot 4 (vlen pe Lotet tjera).** **Kërkesa 6:** Deklarate me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur nga Ekonomik i cili deklaron se ka kapacitet për të mbajtur dhe do të rezerva gjatë gjith implementimit te kontratës per sasinë: Lot 1: 1,000,000 Litra Nafte dhe 60,000 Litra Benzinë; Lot 3: 500,000 Litra Naftë dhe 20,000 Litra Benzinë – **Vlen vetëm per Lot 1 dhe Lot 3 (nese ofertoni vetem ne nj keto Lote duhet te plotësoni deklaratën vetëm për atë Lot.)** **Bazuar në këtë kërkesë pjesë e kontratës do të jetë:** Për Lot 1 Kosovës ndërsa Për Lot 3 – MM/FSK ne koordinim me institucio çdo kohe ka te drejte dhe mund te beje inspektime për te konfi posedimin e rezervave te kërkuara nga OE
	9.2	**Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesio** **Evidenca 1:**Operatori Ekonomik duhet te plotësoj formularin sta dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkëngjis ce përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton liferimin e t furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në nj tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (ce /raporti i përkohshëm i pranimit) të rëndësishme të lëshuar ose

		nënshkruara nga autoriteti i tillë. të gjitha këto dëshmi duhet të vlerën e realizuar. (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës priv dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshk blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë me dëshmi të pagesës ng **Evidenca 2:** Listën e mjetet transportuese për realizimin e kont bashku me kopjet librezave valide te regjistrimit te automjeteve certifikatën/raportet e verifikimit për rrjedhjen dhe vëllimin e au lëshuara nga institucionet kompetente me afat. **Evidenca 3:** Plotësimi i Aneksit 9 – te dosjes se tenderit duke pl kërkesat e lokacioneve te pikave te karburantit. **Evidenca 4:**Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhu raftineria – që garanton që do të furnizoj per kontratën/Lotin e s në të cilën ofertoni – origjinal e nënshkruar dhe vulosur. **Evidenca 5:** Deklarat me shkrim e kualitetit mbi plotësimin e spe teknike per AD-Blue të paraqitura në Aneksin 1. **Evidenca 6:** Deklarate me shkrim e nënshkruar dhe e vulosur ng Operatori Ekonomik

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

IDENTIFIKIMI I TENDERUESVE TË REKOMANDUAR PËR DHËNIE TË KONTRATËS

Nr:	Grupi:		
1	Lot 1 – Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol
2	Lot 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
3	Lot 3 – Furnizim me karburante për nevojat e MM dhe FSK-së		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol
4	Lot 4 – Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Petrol Company - SH.P.K., 810527195	10000	, Magjistralja Pr-F.Kosovë
5	Lot 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
6	Lot 6 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prizrenit (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

Nr:	Grupi:		
	Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.		
7	Lot 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	IP - KOS SH.P.K., 60105444	-10500	Rr. Pennsylvania Nr. 41 (Marigona Residence)
8	Lot 8 – Furnizim me karburante për Rajonin e Ferizajit dhe Gjilanit (Nivel Lokal)		
	Emri i tenderuesit të suksesshëm	**Kodi postar**	**Adresa**
	Grup i Operatorëve Ekonomik HIB PETROL SH.P.K.; HIB Petrol Corporation SH.P.K.; HIB Distribution SH.P.K.	10000	Magjistralja Prishtine- Shkup , km 7, HIB Petrol

DEKLARATË

Pas ekzaminimit dhe vlerësimit të ofertave, komisioni i vlerësimit ka evidentuar se ne aktivitetin e prokurimit: Furnizim me karburante" me numër te prokurimit 201/26300-26-2068-1-1-1 kanë ofertuar pesë (5) operatorë ekonomik. Gjatë vlerësimit te ofertave komisioni i vlerësimit ka konstatuar se operatoret ekonomik:

1. Grupi i Operatorëve Ekonomikë: LAB-OIL SH.P.K. & N.T. "Fer-Petroll"

Grupi i Operatorëve Ekonomikë LAB-OIL SH.P.K. & N.T. "Fer-Petroll" ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 4 dhe 9.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se OE nuk e ka përmbushur kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit, përkatësisht:

Kërkesa nr. 4: Garancion, autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi.

Evidenca nr. 4: Garancion, autorizim apo konfirmim nga prodhuesi/rafineria, me të cilin garantohet furnizimi për kontratën dhe lotin specifik për të cilin ofertuesi ka dorëzuar ofertë, në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur.

Kjo kërkesë ka të bëjë me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale dhe përbën kërkesë thelbësore të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime lidhur me referencat, pasi mungesa e autorizimit apo garancionit nga rafineria/prodhuesi nuk mund të plotësohet apo të ndryshohet përmes sqarimeve pas dorëzimit të ofertës.

Për rrjedhojë, oferta e këtij grupi të operatorëve ekonomikë është vlerësuar si e papërgjegjshme për Lotet nr. 4 dhe 9 dhe nuk rekomandohet për dhënie të kontratës.

2. Operatori Ekonomik: EX FIS-K

Operatori Ekonomik EX FIS-K ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 2, 3, 4, 6 dhe 8.

Për Lotet nr. 2 dhe 4, oferta e OE-së nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertuar tejkalon vlerën e parashikuar të kontratës për këto lote.

Për Lotet nr. 1, 3, 6 dhe 8, Komisioni i Vlerësimit nuk e ka parë të arsyeshme kërkimin e sqarimeve shtesë lidhur me realizimin e kontratave dhe referencat e deklaruara, pasi oferta e këtij OE nuk është oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

Për rrjedhojë, Operatori Ekonomik EX FIS-K nuk rekomandohet për dhënie të kontratës për asnjërin nga lotet për të cilat ka ofertuar.

3. Grupi i Operatorëve Ekonomikë: HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. & HIB Distribution SH.P.K.

Grupi i Operatorëve Ekonomikë HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. dhe HIB Distribution SH.P.K. ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 3, 5, 6 dhe 8.

Për Lotin nr. 5, oferta e grupit të operatorëve ekonomikë nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertuar tejkalon vlerën e parashikuar për këtë lot.

Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se oferta për Lotet nr. 1, 3, 6 dhe 8 është e përgjegjshme dhe përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që **Grupi i Operatorëve Ekonomikë: HIB PETROL SH.P.K., HIB Petrol Corporation SH.P.K. & HIB Distribution SH.P.K.**.t'i jepet kontrata për:

Loti nr. 1: 4.778.714,28 €
Loti nr. 3: 1.579.406,83 €
Loti nr. 6: 623.799,90 €
Loti nr. 8: 1.397.289,71 €

4. Operatori Ekonomik: IP-KOS SH.P.K.

Operatori Ekonomik IP-KOS SH.P.K. ka dorëzuar ofertë për Lotet nr. 1, 2, 5 dhe 7.

Në Aneksin nr. 8 të Dosjes së Tenderit, OE ka deklaruar se posedon referenca të realizuara me subjekte private në vlerë të përgjithshme prej 20.147.250,75 €.

Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se dokumentet e dorëzuara fillimisht së bashku me ofertën nuk kanë qenë të mjaftueshme dhe bindëse për të konfirmuar përmbushjen e kërkesës së Autoritetit Kontraktues lidhur me kapacitetin financiar.

Për këtë arsye, më 07.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtese nga Operatori Ekonomik. Më 10.07.2026, Operatori Ekonomik ka dorëzuar dokumentet sqaruese të kërkuara. Pas shqyrtimit të këtyre dëshmive, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se dokumentacioni i paraqitur nuk ka qenë i mjaftueshëm për të dëshmuar në tërësi përmbushjen e kërkesës së përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë arsye, më 13.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik, ndërsa më 14.07.2026, Operatori Ekonomik ka dorëzuar raportet dhe dëshmitë bankare lidhur me referencat financiare të deklaruara.

Pas analizimit dhe verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar, Komisioni i Vlerësimit ka marrë në konsideratë vlerën prej 10.500.000,00 €, pasi kjo vlerë është vlerësuar e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së kapacitetit financiar për lotet për të cilat Operatori Ekonomik rekomandohet për dhënie të kontratës.
Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që Operatorit Ekonomik **IP-KOS SH.P.K.**t'i jepet kontrata për:
Loti nr. 2: 2.677.820,40 €
Loti nr. 5: 2.124.387,95 €
Loti nr. 7: 1.297.836,42 €
Për Lotin nr. 1, OE nuk rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi oferta e tij nuk është oferta me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

5. Operatori Ekonomik: PETROL COMPANY

Operatori Ekonomik PETROL COMPANY ka dorëzuar ofertë për lotet nr. 1, 2, 3, 4, 5, 7 dhe 9. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se operatori ekonomik i plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe se oferta e tij është e përgjegjshme.

Gjatë procesit të vlerësimit ekonomik është konstatuar se:

për Lotin nr. 3, oferta nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi vlera e ofertës tejkalon vlerën e parashikuar për këtë lot;
për Lotet nr. 1, 2, 5 dhe 7, oferta nuk mund të rekomandohet për dhënie të kontratës, pasi nuk paraqet ofertën me çmimin më të ulët ndër ofertat e përgjegjshme.

Duke u bazuar në rezultatet e vlerësimit dhe në kriterin e dhënies së kontratës, Komisioni i Vlerësimit rekomandon që Operatorit Ekonomik PETROL COMPANY t'i jepet kontrata për:

Lotin nr. 4, në vlerë prej 3.697.763,56 €;
Lotin nr. 9, në vlerë prej 709.792,59 €.

23

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues eshte pale me interes sipas nenit 4.1.26 te LPP-se

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Petrol Company - SH.P.K.**

Përshkrim i përgjithshëm:

Autoriteti Kontraktues (AK) Agjencia Qendrore e Prokruimit ka zhvilluar procedurën e prokurimit me titull: Furnizim me karburante " me nr. Të prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është i ndarë ndare në **9 Pjesë (Lote).**

OE ankues "Petrol Company-SH.P.K." me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë për Pjesët/LOT:

Lot 2–Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror

Lot 5–Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)

Lot 7–Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)

Në këto tri LOT/Pjesë (2,5,7), Autoriteti Kontraktues me vendim të datës: 21.07.2026, ka rekomanduar për kontratë OE IP-KOS-SH.P.K., Prishtinë, ndërsa Operatorit Ekonomik ankues i ka dërguar Letër Standarde për tenderuesin e pasuksesshëm, për shkak se nuk kishte çmimin më të lirë në LOT/Pjesët: 2,5 dhe 7.

Me datë: 27.07.2026, OE ankues ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të Vendimit të AK, ndërsa AK me datë: 03.08.2026 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me datën: 13.08.2026, OE "Petrol Company-SH.P.K.", Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0596, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "IP-KOS-SH.P.K."-Prishtinë, lidhur me këtë aktivitetin e prokurimit: ".

Eksperti shqyrtues ne Pajtim me nenin 114 te LPP-se, ka analizuar pretendimet ankimore të OE ankues dhe në vijim janë pretendimet ankimore dhe shqyrtimi i tyre:

PRETENDIMI ANKIMOR Nr.1

OE ankues në ankesën e tijë, ka vëtëm një pretendim ankimor për Operatorin Ekonomik të rekomanduar, e i cili pretendim lidhet me kërkesën nr.9.1.4 te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të dosjes së tenderit, në të cilën kërkesë Autoriteti Kontraktues ka kërkuar:

Kërkesa 4: Garancion apo autorizim apo konfirmim nga raftineria/prodhuesi

Lidhur me këtë kërkesë në FDT, Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar se dëshmia duhet të jetë si në vijim:

Evidenca 4: Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi / raftineria – që garanton që do të furnizoj per kontratën/Lotin e specifikuar në të cilën ofertoni – origjinal e nënshkruar dhe vulosur.

Pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të Operatorit Ekonomik ankues, dokumentacionit të procedurës së prokurimit, kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit, sqarimit të dhënë nga Autoriteti Kontraktues më datë 20.05.2026, Vendimit të Autoritetit Kontraktues (B58) të datës 21.07.2026, Vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim të datës 03.08.2026, si dhe rrethanave dhe dëshmive të reja të

paraqitura lidhur me autenticitetin e dokumentit të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, vlerësoj se ky pretendim ankimor është i bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në rivlerësim.

Në radhë të parë, është me rëndësi të theksohet se kërkesa nr.9.1.4 e dosjes së tenderit ka përcaktuar në mënyrë të qartë se OE duhej të paraqiste **"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi"**, ndërsa si dëshmi kërkohej dokument origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur, nga prodhuesi/rafineria, i cili garanton furnizimin për Lot/Pjesën përkatëse. Për më tepër, pas kërkesës për sqarim të një operatori ekonomik, Autoriteti Kontraktues, më datë 20.05.2026, ka dhënë një sqarim të prerë se nuk pranohet autorizimi apo konfirmimi nga distributorët dhe se kërkohet dokumenti nga rafineria ku OE furnizohet. Ky sqarim është bërë pjesë e dokumentacionit të tenderit dhe, rrjedhimisht, ka qenë i detyrueshëm për Autoritetin Kontraktues gjatë vlerësimit të ofertave.

Nga dokumenti i paraqitur nga OE i rekomanduar rezulton se në të përmendet BP Oil International Limited, por njëkohësisht dokumenti e lidh furnizimin me **GEGA OIL SH.A.**, të identifikuar si "authorized supplier". Për këtë arsye, në fazën fillestare të vlerësimit ka ekzistuar një çështje reale për tu sqaruar nëse dokumenti përmbushte kërkesën e përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe, veçanërisht, nëse garancioni/konfirmimi ishte vërtet lëshuar dhe ishte i njohur nga vetë prodhuesi, BP Oil International Limited.

Pas Vendimit të Autoritetit Kontrakues (B58), të datës 21.07.2026, Autoriteti Kontraktues ka pranuar informacionin lidhur me kontestimin e kësaj dëshmie nga OE ankues dhe i është drejtuar BP-së për verifikimin e dokumentit. Megjithatë, në mungesë të përgjigjes së BP-së brenda afatit relevant dhe duke respektuar afatet procedurale për kthimin e përgjigjes në kërkesën për rishqyrtim, për OE ankues, përkatësisht afatet 3+3 ditë, Autoriteti Kontraktues është mbështetur në dëshmitë dhe deklarimin e OE të rekomanduar. Në rrethanat që kanë ekzistuar në atë moment, ky veprim mund të kuptohet nga aspekti i respektimit të afateve dhe përfundimit të procedurës së shqyrtimit.

Mirëpo, situata faktike ka ndryshuar në mënyrë thelbësore pas marrjes së përgjigjes së drejtpërdrejtë nga BP Oil International Limited, datë **06.08.2026**. Në këtë përgjigje, BP

ka deklaruar shprehimisht:

"We can confirm that we do not recognize the letter referred to in your correspondence, and we are taking appropriate steps in response."

Kjo deklaratë nuk paraqet më thjesht mungesë të përgjigjes apo mosverifikim të dokumentit. Përkundrazi, kemi një qëndrim të kjartë të subjektit në emër të të cilit pretendohet se është lëshuar dokumenti, se BP nuk e njeh letrën në fjalë. Për rrjedhojë, kjo dëshmi e re ka rëndësi të drejtpërdrejtë për vlerësimin e autenticitetit, vlefshmërisë dhe ekzistimit të dokumentit të përdorur nga OE i rekomanduar për përmbushjen e kërkesës nr.9.1.4 të FDT-së.

Në këtë pikë, deklarata e OE të rekomanduar nuk mund të konsiderohet e barasvlershme me konfirmimin e prodhuesit. Deklarimi i operatorit ekonomik të rekomanduar se dokumenti është autentik dhe se ai mban përgjegjësi për vërtetësinë e tij nuk e zëvendëson verifikimin nga vetë BP Oil International Limited, sidomos kur ky i fundit ka deklaruar më pas se **nuk e njeh dokumentin**.

Përmbushja e kërkesës nr.9.1.4, nuk lidhet vetëm me ekzistencën fizike të një dokumenti në ofertë, por me faktin nëse ai dokument është realisht një garancion, autorizim ose konfirmim i lëshuar dhe i njohur nga prodhuesi/rafineria.

Po aq e rëndësishme është se vetë Autoriteti Kontraktues, duke iu drejtuar BP-së për verifikim dhe më pas duke kërkuar nga OE i rekomanduar që të sigurojë sqarime, ka pranuar se autenticiteti dhe kompetenca e dokumentit ishin çështje relevante për vlerësimin e ofertës. Prandaj, pasi burimi origjinal është shprehur qartë se nuk e njeh dokumentin, kjo rrethanë duhet të trajtohet në mënyrë substanciale gjatë rivlerësimit.

Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë ka edhe fakti se Autoriteti Kontraktues, pas Vendimit të datës: 21.07.2026 (B58), dhe pas kërkesës për rishqyrtim të datës: 27.07.2026, kishte pranuar informacionin mbi kontestimin e dokumentit dhe kishte ndërmarrë veprime për verifikimin e tij. Përderisa në atë moment mungonte përgjigjja e BP-së, Autoriteti Kontraktues ka vepruar mbi bazën e gjendjes së informacionit që

kishte në dispozicion dhe në kuadër të afateve procedurale. Mirëpo, pas datës **06.08.2026**, ekziston një provë e re dhe materiale nga vetë prodhuesi, e cila ndryshon ndjeshëm bazën faktike mbi të cilën është vlerësuar dokumenti.

Prandaj, nuk është e arsyeshme që mungesa e përgjigjes së BP-së në fazën e mëparshme të vazhdojë të përdoret si rrethanë mbështetëse për vlefshmërinë e dokumentit, pasi tashmë ekziston përgjigjja e BP-së, se dokumenti **nuk njihet prej saj**. Kjo rrethanë kërkon një **rivlerësim** objektiv të ofertës së OE të rekomanduar.

Andaj bazuar në të gjitha rrethanat e mësipërme, eksperti shqyrtues,vlerëson se pretendimi ankimor i OE ankues duhet të aprovohet si i bazuar.

Pretendimi ankimor nr.1 është i bazuar

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Petrol Company - SH.P.K.**

Bujar Kuçi